

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
Sulejman Vokshi, No. 14
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
HANIT TË ELEZIT NË DHE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME
31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	1
II. Hyrje	3
III. Opinioni i auditimit.....	5
IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara	8
V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	9
VI. Pasqyrat financiare.....	10
VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	10
VI.2 Cilësia e informatave	10
VII. Ekzekutimi i buxhetit.....	11
VII.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)	11
VII.2 Shpenzimet.....	13
VII.3 Subvencionet dhe transferet.....	13
VII.4 Pasurit dhe Borxhet.....	13
Të Gjeturat	14
Të Gjeturat	15
VIII.Kontrolli mbi menaxhimin.....	15
VIII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	15
VIII.2 Auditimi i Brendshëm.....	16
IX. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Hanit të Elezit.....	17
Shtojca I. Komentet e Komunës dhe përgjigjja e KPMG-së	18

I. Përmbledhje e përgjithshme

KPMG ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Komunës së Hanit i Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare për Instruksione Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Ju lutem gjeni me poshtë një ekstrakt të marrë nga opinionin ynë i auditimit në faqen 5 të këtij dokumenti:

"Sipas mendimit tonë, përveç për mungesë të informacionit të përshkruar në paragrafiet 1 dhe 2 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ("SNKSP") *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr.16/2010 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*."

Mesazhet kryesore ndaj Kryetarit, të cilat na dërguan në kualifikim të opinionit, janë:

- 1 Komuna nuk ka shpalosur shumat e plota në lidhje me pronat, objektet dhe pajisjet në shënimin 27 të pasqyrave financiare. Për më tepër, ka disa mungesa dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:
 - Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
 - Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

- 2 Informatat krahasuese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008 nuk janë të plota dhe të sakta. Në veçanti, çështjet në vijim kanë munguar ose janë shpalosur në mënyrë jo të drejtë në pasqyrat financiare:
 - Pagesat nga palët e treta, në Nenin 9 *Pasqyra e Pranimet dhe Pagesave në Para të Gatshme* nuk janë shpalosur në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008.

Kontrollat e brendshme

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara në më shumë detaje brenda këtij raport.

Konkluzioni ynë është se sistemet e brendshme të Komunës nuk janë të dizajnuara dhe zbatuara si duhet për të eliminuar dobësitë evidente dhe nuk janë implementuar siç duhet.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguroheni që:

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e plotë e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Të vendoset një sistem i automatizuar i faturimit për të gjitha llojet e taksave.
- Të bëhen barazimet e të ardhurave në mes të zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operationale ;
- Të merren masa për rritjen e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e ndryshme;
- Të themelohet një funksion i auditimit të brendshëm dhe një Komitet i Auditimit.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të komentuar mbi gjetjet e prezantuara në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet tona në lidhje me pasqyrat financiare, Sistemet e Kontrollit të Brendshëm, Pasurive Kapitale dhe Jokapitale, Borxhet dhe krijimi i një Komiteti të Auditimit të Brendshëm funksioni të Auditimit. Ndërsa, ata pjesërisht pajtohen me rekomandimet tona në fushën e të hyrave.

Referojuni Shtojces 1 për komentet e menaxhmentit në rekomandimet tona dhe përgjigjen tonë ndaj tyre.

II. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e Komunës së Hanit të Elezit të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ 16/2010 dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG, në emër të Zyrës e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor, në dhe për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2010 për Komunën.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Çështjet të tjera të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të Komunës. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi vlersuar adresimin e rekomandimeve tona të mëparshme nga Komuna si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Rekomandimet tona kanë të bëjnë me përmirësimet që duhet të bëhen në lidhje me pasqyrat financiare që të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrative 16/2010 dhe Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për Raportimin Financiar të Kontabilitetit në baza keshi. Rekomandimi ynë është dorëzuar përmes një audit memorandumit në datë 8 Dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar në dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2010;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrës sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion mbi Pasqyrat Vjetore Financiare me 31 Dhjetor 2010.

ONISA përcakton kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet në lidhje me opinionin tonë për pasqyrat financiare të Komunës.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2, që përfshin një ekstrakt nga ISSAI 4000.

III. Opinioni i auditimit

Raporti i Auditorit të Pavarur

Drejtuar Kuvendit Komunal

Komuna e Hanit të Elezit, Kosovë

Prishtinë, 3 Qershor 2011

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare bashkëlidhur të Komunës së Hanit të Elezit (“Komuna”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) – *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe me Udhëzimin Administrativ Nr.16/2010 Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare për Instruksione Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur deri të një siguri e arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të grumbulluar dëshmi auditimi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi jonë, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne e marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Baza për një opinion të kualifikuar

1. Komuna nuk ka shpalosur shumat komplete në lidhje me pronat, objektet dhe pajisjet në Shënimin 27 të pasqyrave financiare. Për më tepër, ka disa mungesa dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:

- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.
- Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

2. Informatat krahasuese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008 nuk janë të plota dhe të sakta. Në veçanti, çështjet në vijim kanë munguar ose janë shpalosur në mënyrë jo të drejtë në pasqyrat financiare:

- Pagesat nga palët e treta, në Nenin 9 *Pasqyra e Pranimit dhe Pagesave në Para të Gatshme* nuk janë shpalosur në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç mangësive të informacionit të përshkruar në paragrafet 1 dhe 2 për bazat e kualifikimit të opinionit, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet materiale pagesat dhe pranimet për vitin 31 Dhjetor 2010 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2010 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- 1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Sidoqoftë, pasi që Free Balance nuk perdoret për të regjistruar pagesat nga palet e treta, pronen objektet dhe pajisjet ose faturat e papaguara, ai nuk mund të perdoret për të prodhuar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse.
- 2 Megjithëse Kryetari dhe Zyrtari i Lartë Financiar ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ishte në gjendje të përgatiste një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.
- 3 Pasi Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës automatizuar të faturimit, ekziston pasiguria lidhur me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë, dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm, për të raportuar një raport të saktë të shkallës së mbledhjes së të hyrave, dhe monitorimin e mbledhjes së të hyrave vetanake në kohën e duhur.
- 4 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe pagesa të parasë së gatshme mund të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka kryer ndonjë proces formal që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizjoneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch

Rruga Sulejman Vokshi, Nr. 14

Prishtinë

Kosovë

IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të fundvitit 31 Dhjetor 2009 janë dhënë pesë rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, njëri që ka të bëjë me pagat dhe medijtjet është adresuar plotësisht ndërsa katër të tjerat mbeten për ta zgjidhur,, për çështjet me siç janë:

- Pasqyrat Financiare duhen përgatitur në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e plotë e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Të mbahet një sistem faturimi automatik për të gjitha llojet e taksave, duhet të kryhet barazimi i të hyrave në mes të zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionale. Gjithashtu duhet të merren masa për ngritjen e nivelit të mbledhjes së taksave; dhe
- Të themelohet një funksion i auditimit të brendshëm dhe një Komitet i Auditimit.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka shkaktuar që të japim të njëjtat gjetje sikurse në vitin 2009.

V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2010 Realizimi	2009 Realizimi
Grandi i Qeverisë – Buxheti	1,127,000	1,160,000	1,160,000	1,151,000	1,022,000
Të hyrat vetjake	128,000	128,000	275,000	251,000	188,000
Donacionet e vendit	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	-	27,000	27,000	10,000
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	1,255,000	1,288,000	1,462,000	1,429,000	1,220,000
Rrogat dhe pagat	736,000	756,000	756,000	748,000	647,000
Mallra dhe shërbime	156,000	169,000	185,000	185,000	141,000
Shpenzimet komunale	29,000	29,000	31,000	31,000	22,000
Subvencionet dhe transferet	8,000	8,000	30,000	30,000	25,000
Investimet Kapitale	326,000	325,000	460,000	435,000	385,000
Rezervat	-	-	-	-	-
II. Gjithsej shpenzimet	1,255,000	1,288,000	1,462,000	1,429,000	1,220,000
Ndryshimi I-II	-	-	-	-	-

Shumat e buxhetuara janë nxjerrë nga pjesët në vijim në kuadër të Pasqyrave Financiare, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010: Neni 10 Raporti i ekzekutimit të buxhetit, Neni 17 Shënimi 31 Barazimi në mes Ndarjet Buxhetore Origjinale dhe Përfundimtare.

VI. Pasqyrat financiare

VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010 “UA 16/2010”, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Komuna ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2010 me përjashtim të plotësisë dhe shpalosjes së ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve në notën 27 të Pasqyrave Financiare;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 29/01/2011 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (“MEF”);
- Pasqyrat Financiare janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MEF gjatë vitit 2010.

Konkluzioni

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarit të sigurojë që përgatitjen e pasqyrave financiare ta bazojë në procedura që janë të dizajnuara të sigurojnë se informacioni i kërkuar, është regjistruar, procesuar dhe përmbledhur si duhet në pasqyrat financiare.

Komuna duhet të përgatisë pasqyrat financiare në gjuhën serbe.

VI.2 Cilësia e informatave

Gjetjet tona të auditimit dhe rekomandimet në këtë dokument tregojnë se duhen bërë përmirësime në cilësinë e informacionit të pranuar dhe të paraqitur në pasqyrat financiare nga Komuna.

Rekomandimi 2

Ju lutem shikoni rekomandimet përgjatë këtij dokumenti për këshilla sesi mund të përmirësohet kualiteti i informacionit.

VII. Ekzekutimi i buxhetit

VII.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të Gjeturat

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Faturimet nga Komuna për lejet e biznesit dhe të ardhurat nga qeraja nuk regjistrohen. Për këto të hyra regjistrohen vetëm arketimet e parave të gatshme.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhshmerise ose të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake.
- *Barazimi i të hyrave.* Nuk është bërë ndonjë barazim i të dhënave të mbajtura në kontabilitet me ato të zyrtarit të të hyrave apo departamenteve operationale për vitin 2010. Për më tepër, Komuna nuk na ka ofruar një regjistër të detajuar për të gjitha llojet e të hyrave.
- *Të hyrat nga lejet e biznesit.* Komuna nuk merr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë numrin total të bizneseve aktive në Komunë. Si pasojë, biznese joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen, ndërsa bizneset aktive mund të mos ngarkohen me obligimin përkatës.
- *Të hyrat nga tatimi në pronë.* Në fund të vitit 2008, Komuna ka themeluar një komision vleresimi të pronës, i cili ka identifikuar një numër pronash të reja prej përafërsisht 40% të totalit të pronave. Kjo listë nuk është përditësuar për vitin 2009 dhe 2010. Kjo listë është përdorur për faturim të tatimit në pronë për vitin 2010.
- *Ndarja e detyrave.* Departamenti i tatimit në pronë konsiston në vetëm një person që ishte përgjegjës për regjistrimin e pronave të reja, përgaditjen e dokumenteve relevante si dhe futjen e aplikanteve të rinj në sistemin e faturimit automatik. Për shkak të mungesës së ndarjes së detyrave, gabime mund të ndodhin e të cilat nuk rregullohen në kohë.
- *Dobësitë në sistemin e faturimit automatik.* Sistemi i faturimit të tatimit mbi pronën është i centralizuar dhe Komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave meqenëse ajo bëhet në mënyrë automatike nga sistemi.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për te përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe te faturimit në mënyre që te sigurojë kontrole të sigurta, eficiente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me keto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës te konsiderojë pikat si ne vijim:

- Implementimin e një sistemi te faturimit qe përfshin detaje te përditësuara për paguesit, adresën e tyre te tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se te hyrave nga këta pagues. Qasje ne informacion te tille duhet te kenë vetëm një numër te limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave ne sistem në mënyre që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike ne mes te sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre qe informacioni te procesohet automatikisht ne librin kryesor te kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime te rregullta midis dy sistemeve në periudha te rregullta për te gjitha tipet e te hyrave. Ne rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe te zgjidhen brenda afatit te caktuar.
- Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe te bëhen barazime të rregullta ne mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me sherbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme ne rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.

VII.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimet

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

2.2 Blerjet tjera

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

2.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet,)

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

VII.3 Subvencionet dhe transferet

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

VII.4 Pasurit dhe Borxhet

4.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

4.2 Trajtimi i të arkëtueshmve

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje për tu raportuar në këtë pikë.

4.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Të Gjeturat

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj.

Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë mbi patundshmëritë, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër për patundshmëri ose në Gjykatë.

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë nga Komuna nuk ka filluar. Megjithatë Komuna ka krijuar në vitin 2008 një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive, ky komitet nuk ka përfunduar ende ndonjë listë dhe si pasojë pasuritë nuk janë regjistruar apo vlerësuar deri më 31 Dhjetor 2010.

Nuk ka patur numërim fizik të pasurisë për vitin 2010, dhe pa një numërim të tillë në nuk ishim në gjendje që të verifikojmë ekzistencën fizike të pasurive.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme si praktika më e mirë në raste të tilla.
- Të bëjë numërimin e rregullt fizik për të siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.
- Të bëjë përpjekje shtesë në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.

4.4 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte në vlerë prej EUR 9,433. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2011.

Të Gjeturat

Neni 13.1 ti Udhëzimit Administrativ Nr.16 / 2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore thotë se: *"Për të gjitha mallrat dhe shërbimet e pranuar, pa marrë parasysh kategorinë ekonomike, organizata buxhetore duhet të paguajë për to deri në fund të vitit fiskal - 31 Dhjetor 2010"*. Kemi vërejtur se komuna ka paraqitur faturat e papaguara që lidhen me mallra dhe shërbime në nenin 13, Shënimi 25 të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë se komuna do të ndermerrë hapa të mëtijshme për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve lokale.

VIII. Kontrolli mbi menaxhimin

VIII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Të Gjeturat

Informacioni parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Meqenëse Free Balance nuk është përdorur për të regjistruar pagesat nga palët e treta pronat, objektet dhe pajisjet, apo faturat e papaguara, nuk mund të përdoret për të prodhuar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura. Megjithatë pagesat nga palët e treta janë shaplosur bazuar mbi lista të mbajtura manualisht, shënimet si ne vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare për vitin e mbaruar më 31 Dhjetor 2010:

- Neni 16, Shënimi 27. Pasuritë Jo-financiare

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë që përgatitja e pasqyrave financiare të bazohet në pajisje dhe procedura që janë të dizajnuara të sigurojnë se informacioni i kërkuar, është regjistruar, procesuar dhe përmbledhur si duhet në pasqyrat financiare.

VIII.2 **Auditimi i Brendshëm**

Të Gjeturat

Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi dhe nje funksion të Auditimit të brendshëm.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryetarit te Komunës të sigurojë qëë konsiderojë krijimin e një funksioni te Auditimit te brendshëm dhe një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë ‘udhëheqje të korporatës’. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore; dhe
- Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.

IX. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Hanit të Elezit

Konkluzionet e përgjithshme

Ju lutem shikoni audit opinionin.

Rekomandimi i përgjithshëm

- Pasqyrat Financiare duhen përgatitur në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e plotë e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Të mbahet një sistem faturimi automatik për të gjitha llojet e taksave, duhet të kryhet barazimi i të hyrave në mes të zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionale. Gjithashtu duhet të merren masa për ngritjen e nivelit të mbledhjes së taksave; dhe
- Të themelohet një funksion i auditimit të brendshëm dhe një Komitet i Auditimit.

Shtojca I. Komentet e Komunës dhe përgjigja e KPMG-së

REKOMANDIMET	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG
<p>Rekomandimi 1: Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë që përgaditjen e pasqyrave financiare të bazoj ne pajisje dhe procedura që janë të dizajnuara të sigurojnë se informacioni i kërkuar, është regjistruar, procesuar dhe përmbledhur si duhet në pasqyrat financiare. Komuna duhet gjithëashtu që të përgadisë Pasqyrat Financiare në gjuhën serbe.</p>	X			<p>Zyrtari përgjegjes për përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare nuk ka marë pjesë në asnjë trajnim për përgatitje e pasqyrave financiare sepse asnjë trajnim i tillë nuk është organizuar nga MEF.</p> <p>Pasqyrat Financiare nuk janë përgatitur në gjuhën serbe për arsye se nuk kemi perkthyes të gjuhës serbo – kroate.</p>	Komuna është pajtuar me rekomandimet tona.
<p>Rekomandimi 3: Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyre që të siguroj kontrollin të sigurt, eficient dhe efektiv në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e mëdha dhe të siguroj që vendimet</p>		X		<p>Pika e parë: ne pajtohemi me rekomandimin tuaj.</p> <p>Sa i përket pikës së dytë ne nuk pajtohemi me këtë pikë sepse ne konsiderojmë që Komuna i ka të gjithë regjistrat e debitorëve ndërsa pagesat e tjera kryhen kur shërbimi ndodh. Ndërsa sa i përket normës së mbledhshmërisë së llogarive të arketueshme në për çdo vit synojmë të mbledhim të gjitha borxhet e mbetura, mirepo kjo nuk po arrihet pasi që</p>	Komuna pajtohet pjesërisht me rekomandimet tona.

<p>ne lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e te hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës te konsideroj pikat si ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Implementimin e një sistemi te faturimit qe përfshin detaje te përditësuara për pagesit, adresën e tyre te tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se te hyrave nga këta pagues. Qasje ne informacion te tille duhet te kenë vetëm një numër te limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti. •Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave ne sistem ne mënyre qe të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet te autorizohet dhe te rishikohet. •Të ekzistojë një lidhje automatike ne mes te sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre qe informacioni te procesohet automatikisht ne librin kryesor te kontabilitetit. •Të ushtrojë barazime te rregullta midis dy sistemeve ne periudha te rregullta për te gjitha tipet e te hyrave. Ne rastet kur ka diferenca, ato duhet te hulumtohen dhe te zgjidhen brenda afatit te caktuar. •Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe te bëhen barazime te rregullta ne mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me sherbimet nga zyra operacionale. 				<p>kemi nje borgj te trashëguar vite me radhë nga komuna e Kaçanikut.</p> <p>Pika e tretë pjeserisht pajtohem me këtë rekomandim.</p> <p>Në lidhje me pikën katër ne akoma nuk kemi një listë të tillë sepse nuk kemi një kod tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë sepse të gjitha bizneset janë evidentuar tek lista e Komunës së Kaçanikut. Në lëshojmë fatura tek të gjitha bizneset që i takojnë Komunës tonë dhe ato kanë të drejtën të ankohen në rastet kur biznesi i tyre nuk është aktiv në mënyrë që të fshihen nga lista kur ata të prezantojnë të gjithë evidencën për shuarjen e biznesit.</p> <p>Për pikat e tjera në vijim: lidhur me tatimin në pronë ne mund të sqarojmë se nga mungesa e stafit në këtë fushë nuk kemi arritur të bëjmë freskimin e bazës së të dhënave me prona të reja, ndërsa sa i përket dobësive në sistemin e faturimit të tatimin në pronë ky është një sistem që përdoret në të gjitha komunat e Kosovës.</p>	
--	--	--	--	--	--

<p>Kjo është veçanërisht e rëndësishme ne rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.</p> <ul style="list-style-type: none"> •Te siguroj implementimin e procedurave përkatëse në mbledhjen e keshit 					
<p>Rekomandimi 4</p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do te konsideroje si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës te pronës, objekteve dhe pajisjeve. • Te përfshije burime shtese ne regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive te Komunës. Përfshirja e vlerësuesve te pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme si praktika me e mire ne raste te tilla. •Te beje numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve te tyre dhe te barazojë rezultatet e numërimit me te dhënat ne kontabilitet dhe regjistër. •Te beje përpjekje shtese ne lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive. 	X			<p>Sa i përket pikës së parë kjo vërejtje qëndron mirëpo ne shpresojmë se me një shpërndarje të re të detyrave ne do të themelojmë nje komision i cili do të bëjë evidentimin e të gjithë pasurisë së komunës brenda ketij viti.</p> <p>Pika e dytë: Deri ne fund të qershorit të vitit të kaluar ne nuk kishim sektorin e kadastres në kuadër të komunës sonë kështu që çdo informatë lidhur me patundshmëritë e komunës duhej të kërkohej në Komunën e Kaçanikut. Që nga qershori këto çështje janë zgjidhur dhe Komuna posedon të gjithë informacionin e nevojshëm. Bazuar në këtë informacion Komuna do të formojë një komision dhe do të kemi një liste të kompletuar më pasuri të vlerësuara për 31 Dhjetor 2011.</p> <p>Pika e tretë: edhe kjo e gjetur është evidente mirëpo ne së shpejti do të bëjmë rikonsolidimin e këtyre komisioneve dhe do të fillojmë me punë.</p> <p>Pika e katërt: ne shpresojmë se sa shumë shpejt do të krijojmë një bazë të të dhënave në të</p>	Komuna pajtohet me rekomandimet tona.

				cilën do të pasqyrohet e tërë pasuria e komunës dhe me me këtë do të mundësohet edhe numërimi fizik i tyre.	
<p>Rekomandimi 5:</p> <p>Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të siguroj se komuna do të ndermer hapa të metutjeshëm për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kerkesat e ligjeve dhe rregulloret lokale.</p>	X			Ne kemi prezentuar në nenin 13 në pasqyrat financiare faturat e papaguara ku një pjesë e madhe e faturave janë faturat e muajit 12 për shpenzime komunale ndërsa për faturat që kanë të bëjnë me mallërat dhe shërbimet kanë mbetur si rezultat i marrjes me vonesë të faturave dhe disa nga to nuk janë paguar si pasojë e mungesës së fondeve.	Komuna pajtohet me rekomandimet tona.
<p>Rekomandimi 6:</p> <p>Përgaditja e pasqyrave financiare të bazohet ne pajisje dhe procedura që janë të dizajnuara të sigurojnë se informacioni i kërkuar, është regjistruar, procesuar dhe përmbledhur si duhet në pasqyrat financiare.</p>	X			Zyrtari përgjegjes për përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare nuk ka marr pjesë në asnjë trajnim për përgatitje e pasqyrave financiare sepse asnjë trajnim i tillë nuk është organizuar nga MEF.	
<p>Rekomandimi 7:</p> <p>Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë që të konsiderojë krijimin e një funksioni të Auditimit të brendshëm dhe një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë ‘udhëheqje të korporatës’. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime</p>	X			Gjatë vitit 2010 nuk e kemi pasur të lejuar rritjen e stafit nga ana e MEF-it dhe për këtë arsye nuk kemi mundur që të krijojmë një komitet të auditimit dhe funksionimin e auditorit të brendshëm.	Komuna pajtohet me rekomandimet tona.

<p>në sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës; - Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi; - Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; - Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore; - Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm. 					
---	--	--	--	--	--

Shtesa 2 Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të perdorua nga KPMG në Raportin e Auditimit Vjetor për vitin 2009

(Marrë nga ISSAI 4000)

9. Një opinion auditimi normalisht jepet në një format standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kuadrit ligjor për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të tregojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, nëse është i kualifikuar, është i kualifikuar për disa aspekte apo është një opinion kundër (paragrafi 14) ose një refuzim për të dhënë opinion (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur audituesi është i kënaqur në cdo aspekt material për sa vijon:

- (a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza kontabël të pranueshme dhe politika të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;
- (b) Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statutores dhe rregulloret përkatëse;
- (c) Sipas njohurisë së audituesit mbi njësinë e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare është e qëndrueshme; dhe
- (d) Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale.

11. **Tërheqje e vëmendjes.** Në disa rrethana audituesi mund të mendojë se lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejt pasqyrat financiare nëse atij nuk i tërhiqet vëmendja për çështje të rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, audituesi që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keqinterpretuhej si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies se kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “tërheqjes së vëmendjes” paraqiten në një paragraf të vecantë prej opinionit. Megjithatë, audituesi nuk duhet të perdorë një terheqje vëmendje për çështje të cilat lidhen me mungesën e shpalosjes së duhur të informacionit në pasqyrat financiare, dhe as si një alternativë apo zëvendësuese të kualifikimit të opinionit.

